

Parathënie / Introduction

Ky buletin është konceptuar të shërbejë si një instrument informimi i cili do të përçojë brenda dhe jashtë Shqipërisë zërin e komunitetit Rom dhe Egjiptian. Ai do të jetë në funksion të aktiviteteve të rrjetit i cili është themeluar si një inisiativë e Unionit "Amaro-Drom", në kuadër të projektit "Përmirësim i qëndrueshëm i jetesës së komuniteteve Rome në Shqipëri", financuar nga We Effect.

Ky botim periodik (vjetor) është një mjet për publikun e gjerë, për institucionet qeveritare/ jo qeveritare dhe këdo që është i interesuar të njihet me përpjekjet për të identifikuar dhe zgjidhur problematikat e këtij komuniteti.

Botimi i këtij buletini është një rast i mirë për të dokumentuar aktivitetet, iniciativat lobuese dhe advokuese të shoqërisë civile Rome dhe Egjiptiane në Shqipëri.

Rrjeti i ngritur me përbërjen e organizatave Rome dhe Egjiptiane, është krijuar mbi bazën e një procesi demokratik dhe si i tillë, ai vepron si një instrument ku fjala, mendimi, zëri të tingëllojë jo në vesh të shurdhër, por të jetë një këmbanë e fortë ku të dëgjohet zëri i vërtetë i dy komuniteteve që kërkojnë barazi të plotë dhe vullnetin politik për të mbijetuar.

This bulletin is designed to serve as an information tool which will transmit within Albania and abroad the voice of Roma and Egyptian communities. It will be in the function of the network activities which was established as an initiative of the Union "Amaro Drom" in the framework of the project "Sustainable improvement of livelihood of Roma communities in Albania" funded by We Effect.

This periodical (annual) publication, is a tool for the general public, government institutions / non-government and anyone who is interested to become familiar with efforts on identifying and solving the problems of this community.

The publication of this newsletter is a good opportunity to document activities, lobbying and advocacy initiatives of Roma and Egyptian civil society in Albania.

The network of Roma and Egyptian organizations was established on the basis of a democratic process and as such, it acts as an instrument where the word, thought, voice, sounds not on deaf ears, but it is a strong bell where, the true voice of the communities that require full equality and political will to survive is heard.

Eshtë koha që të dy këto komunitete, të cilat vuajnë vështirësitë social-ekonomike dhe diskriminimin për shkak të etnisë, të shpalosin vlerat e tyre në bashkjetesë. Është koha që përmes zërit të tij, rrjeti kombëtar i organizatave Rome dhe Egjyptiane të sjellë ndryshim në klimën, vullnetin politik dhe integrim në jetën e përditshme të dy komuniteteve tona.

Dëshiroj të falenderoj të gjithë anëtarët e rrjetit Rom dhe Egjyptian për kontributin e dhënë gjatë këtij viti.

Organizatrat:

"I romni e tasjaraqi"

"Qendra për zhvillimin e gruas rome",

"Cigan muzik",

"Qendra për te drejtat e gruas rome",

"Disutni Albania",

"Voice of Roma in Albania"

"Romano sezi"

"Shpresë për të varfrit",

"Integrimi rinor komunitar"

"Realiteti Rom në Shqipëri CERA-AL"

"Vllazëria Egjyptiane"

"Shoqata Rome dhe Egjyptiane ALEANCA PËR INTEGRIM EUROPIAN"

Artistin vizual: Sead Kazanxhiu

Aktivistët:

Ibrahim Likzelia; Emiliano Aliu

Sinqerisht,

Skender Veliu

Drejtor Ekzekutiv

Unioni Amaro Drom

It is time that the two communities that suffer socio-economic difficulties and discrimination due to ethnicity, to reveal their values in cohabitation. It's time that through its voice, the national network of Roma and Egyptian organizations brings change in climate, political will and integration in everyday life for both of our communities.

I would like to thank all the members of the Roma and Egyptian network for their contribution during this year.

Organizations:

"I romni e tasjaraqi"

"Roma Women Center for Development"

"Cigan muzik",

"Roma Women Rights Center"

"Disutni Albania",

"Voice of Roma in Albania"

"Romano sezi"

"Hope for the Poor"

"Community Youth Integration"

"The Reality of Roma in Albania CERA-AL"

"Egyptian Brotherhood"

"Roma and Egyptian Association THE ALLIANCE FOR THE EUROPEAN INTEGRATION"

The visual artist: Sead Kazanxhiu

Activists:

Ibrahim Likzelia; Emiliano Aliu

Sincerely,

Skender Veliu

Executive Director

Amaro Drom Union

PËRMBAJTJA / CONTENT

1. Rreth projektit / <i>About the project</i>	4
2. Rrjeti Kombëtar i Organizatave Rome dhe Egjiptiane <i>National Roma and Egyptian Organization</i>	5
Qëllimi / <i>The goal</i>	6
Misioni / <i>The mission</i>	6
Vizioni / <i>The vision</i>	6
Fokusi i rrjetit / <i>Network focus</i>	6
3. Profili i Organizatave Rome & Egjiptiane në rrjet (shoqatat, misionet, aktivitetet) <i>The profile of Roma & Egyptian organization (organizations, missions, activities)</i>	7
Unioni "Amaro-Drom" / "Amaro-Drom" Union	8
Qendra për të Drejtat e Gruas Rome / "Roma Woman Rights Centre"	10
Disutni Albania / "Disutni Albania"	11
'I Romni e Tasjaraqi' Gruaja Rome e së Nesërme / Roma Women of Tomorrow	12
Romano Sezi, Elbasan / "Romano Sezi"	13
Voice of Roma in Albania / "Voice of Roma in Albania"	14
"Realiteti i Romëve në Shqipëri" (CERA), Pogradec / "The Reality of Roma in Albania"	15
Shoqata "Shpresë për të varfërit" / The association "Hope for the Poor"	16
Integrimi Rinor Komunitar / Community Youth Integration	17
Shoqata "Vllazëria Egjiptiane" / "Egyptian Brotherhood"	18
Shoqata Rome dhe Egjiptiane "Aleanca për Integrim Europian" / Roma and Egyptian Association, "The Alliance for the European Integration"	19
4. Krijimi i rrjetit kombëtar të organizatave rome / egjiptiane <i>Establishment of national network of roma / egyptian organizations in albania</i>	20
Takime të rrjetit / <i>Network meetings</i>	21
Disa nga çështjet që u diskutuan / <i>Some of the issues discussed</i>	22
5. Workshop ndërgjegjësues "Të drejtat e Minoritetit Rom" <i>Workshop on "The rights of Roma Minority"</i>	25
Inisiativa të ndërrmarra nga rrjeti / <i>Initiatives taken by the network</i>	26
Disa sygjerime për vazhdimësinë / <i>Some suggestions for the future of the network</i>	29
6. Lobim dhe advokim i rrjetit në nivel kombëtar <i>Joint lobby and advocacy by the network at the national level</i>	30
Initiative lobimi për situatën e strehimit në Korçë / <i>Lobbying initiative for the housing situation in Korça</i>	31
Rrjeti bëhet pjesë e iniciativës për firmosjen e deklaratës mbi legalizimin e shtëpive / The network has been part of the initiative for signing the declaration about housing legalization	32



1. RRETH PROJEKTIT / ABOUT THE PROJECT

Projekti “Përmirësim i qëndrueshëm i jetesës së komuniteteve Rome në Shqipëri” është një projekt tre vjeçar (2014-2016) i cili zbatohet në komunitetet Moravë, Grabian, Plug, Gramsh & Zhame.

Projekti financohet nga We Effect dhe është i fokusuar në tre komponentë kryesorë:

- 1 - Ngritje kapaciteti;
- 2 - Zhvillim biznesi;
- 3 - Lobim dhe advokim.

Ndër të tjera, ky projekt synon që të kontribuojë në forcimin e zërit Rom në Shqipëri përmes Lobimit dhe Advokimit.

The project “Sustainable improvement of livelihood of Roma communities in Albania” is a three year project (2014-2016) implemented in Morava, Grabian, Plug, Gramsh & Zhame.

The project is funded by We Effect and focused in three main components:

- 1 - Capacity building;
- 2 - Business development;
- 3 - Lobby and advocacy.

Among others the project aims to contribute in strengthening Roma voice in Albania through Lobby and Advocacy.

**Rrjeti kombëtar i organizatave Rome / Egjyptiane
“Së bashku për forcimin e zërit Rom / Egjyptian
në Shqipëri”**

**National network of Roma and Egyptian organizations
“Together for strengthening Roma / Egyptian voice in
Albania”**

>> >> >> 2

Rrjeti kombëtar i organizatave Rome / Egjyptiane, "Së bashku për forcimin e zërit Rom dhe Egjyptian në Shqipëri", u krijua në 18 Qershor të vitit 2014, si një iniciativë e Unionit për Zhvillimin dhe Integrimin e Minoritetit Rom në Shqipëri Amaro-Drom.

Këtij rrjeti deri tani, i janë bashkangjitur 13 organizata

Rome dhe Egjyptiane, të cilët synojnë ndërmarrjen e iniciativave të përbashkëta, në dobi të forcimit dhe zhvillimit të këtyre komuniteteve.

Rrjeti mbetet i hapur për të mirëpritur organizata apo shoqata të tjera, të cilat shprehin interesin për të qënë pjesë e këtij misioni.

Qëllimi:

Forcimi i zërit Rom/Egjyptian në nivel kombëtar, duke lobuar, advokuar, shkëmbyer eksperiencat dhe praktikatat më të mira për çështjen Rome/Egjyptiane.

Misioni

- Të advokojë dhe lojojë në emër të komunitetit Rom dhe Egjyptian në Shqipëri.
- Të ndërgjegjësojë institucionet shtetërore dhe shoqërinë, për të njohur dhe respektuar Romët dhe Egjyptianët.
- Të nxisë pjesëmarrjen aktive të përfaqësuesve Rom dhe Egjyptian.
- Të koordinojë dhe promovojë eksperiencat më të mira, në mbrojtjen e komunitetit Rom dhe Egjyptian në Shqipëri.

Vizioni

Përmes punës së përbashkët, për një ndryshim pozitiv, në përmirësim të jetës së komunitetit Rom dhe Egjyptian në Shqipëri.

Rrjeti do të fokusohet në çështjet si:

- Ndërmarrjen e iniciativave për ndryshime të kuadrit ligjor; për të influencuar pozitivisht politikatat sociale-ekonomike dhe shëndetësore për Romët dhe Egjyptianët;
- Do të ketë rol ndikues në lobim dhe advokim në nivel kombëtar, për përfshirjen e grave dhe jo vetëm;
- Do të ndërmarrë inisiativa që do të ndikojnë në zbutjen e kriterëve për procesin e strehimit;
- Rekomandime favorizuese ndaj Romëve dhe Egjyptianeve, për sa i përket edukimit dhe punësimit;
- Rritja e kapaciteteve të organizatave Rome/Egjyptiane dhe aktivistëve në fushën e lobimit dhe advokimit.

The national network of Roma/Egyptian organizations "Together for strengthening Roma and Egyptian voice in Albania" it was established on June 18th 2014, as an initiative of the Union for Development and Integration of Roma minorities in Albania.

Until now, 13 Roma and Egyptian organization

are part of this network, which aims to undertake common initiatives for strengthening and developing these communities.

The network welcomes other organizations or associations that express the interest to be part of this mission.

Goal:

Strengthening Roma/Egyptian voice in national level, by lobby, advocacy, exchanging experiences and best practices on Roma/Egyptian issues

Mision

- To advocate and lobby on behalf of Roma and Egyptians in Albania.
- To sensitize state institutions and society to recognize and respect the Roma and Egyptians.
- To promote the active participation of Roma and Egyptian representatives.
- To coordinate and promote best practices in the protection of Roma and Egyptians in Albania.

Vision

Together for a positive change, to improve the lives of Roma and Egyptians in Albania

The network will be focus on issues such as:

- To undertake initiatives to change the legislation; to positively influence the socio-economic and health policies for Roma and Egyptians.
- To lobby and advocate on national level for the inclusion of women and not only.
- To undertake initiatives that will mitigate the criterias for housing process.
- Positive recommendations for Roma and Egyptians in terms of education and employment.
- To increase the capacities of Roma and Egyptians organization and activists on lobby and advocacy.

PROFILI I ORGANIZATAVE NË RRJET

THE PROFILE OF NETWORK ORGANIZATIONS

>> >> >> 3



Unioni për Zhvillimin dhe Integrimin e Minoritetit Rom në Shqipëri “Amaro Drom”

Unioni për Zhvillimin dhe Integrimin e Minoritetit Rom në Shqipëri “Amaro Drom”

Unioni “Amaro-Drom” është një organizatë jo qeveritare, jo politike, jo fitimprurëse dhe ka për qëllim zhvillimin dhe integrimin e këtij minoriteti përkrah shoqërisë shqiptare.

Unioni u krijua më 4-Mars 1996 dhe vepron në të gjithë territorin e Shqipërisë, organizatë me antarësi, e vetmja nga OJF-të Rome që vepron nga niveli lokal, në atë kombëtar (me 32 degë) dhe ndërkombëtar.

Misioni i Unionit Amaro-Drom:

- Mbrojtja e identitetit dhe të drejtave të komunitetit Rom.
- Rritja e nivelit të edukimit dhe arsimimit në komunitetin Rom.
- Përmirësimi i kushteve socio-ekonomike.
- Integrimi i komunitetit, kryesisht gjenerata e re në shoqërinë maxhoritare.

Për përmbushjen e këtij misioni, Unioni “Amaro-Drom” mbështet dhe drejton aktivitete të ndryshme, siç janë:

- Projekte në fushën e infrastrukturës, shëndetit, edukimit, të drejtave të njeriut, trafikimit, kulturës, artit, traditave, mbështetje të bizneseve të vogla dhe aktivitete të tjera që kanë të bëjnë me rritjen e të ardhurave në komunitetin Rom, aktivitete për të rinjtë dhe gruan Rome;
- Trajnime, seminare, tryeza të rrumbullakta, kërkime dhe raste studimore, konferenca të ndryshme etj;
- Fushata ndërgjegjësimi, ekspertizë, informacion, publikime në fusha të ndryshme që kanë të bëjnë me çështjen Rome etj.

“Së bashku të përmirësojmë të ardhmen e minoritetit Rom; të forcojmë zërin Rom në Shqipëri”

Skënder VELIU

Drejtor Ekzekutiv
UNIONI i Romëve të Shqipërisë
Amaro-Drom

Union for Development and Integration of Roma Minority in Albania “Amaro Drom”

“Amaro- Drom” UNION is a non-government, non-political, non-profitable organization that aims: The development and integration of Roma community abreast Albanian society.

The Union was founded on March 4th, 1996 and operate in the whole Albanian territory, the only Roma organization with membership that acts from local level, where it is the most part of Roma people, to national (32 branches) and international level

The mission of Amaro-Drom Union:

- Protection of the identity and rights of Roma community in Albania.
- Increasing the education level of Roma community.
- Improvement of social and economic conditions.
- Integration of the community, especially new generation in the Albanian society.

In order to accomplish its mission, “Amaro Drom” UNION supports and conducts various activities, such as:

- Various projects in the areas of infrastructure, health, education, human rights, culture, art, traditions and customs, support of small businesses and other activities aiming at the increase of income of the Roma community, involvement activities for Roma women and youth;
- Training seminars, round tables, research and study cases and various conferences.;
- Awareness and advertising campaigns, expertise, information, publications and consultancy in various fields having to do with Roma issues, etc.

“Together to improve the future of Roma; strengthen the voice of Roma in Albania”

Skënder VELIU

Executive Director
Albanian Roma Union
Amaro-Drom



Qendra për të Drejtat e Gruas Rome

“Qendra për të Drejtat e Gruas Rome” është një qendër jo fitimrurëse, jo qeveritare e themeluar në Nëntor të vitit 2012 nga grup grash aktiviste.

Misioni i Qendrës për të Drejtat e Gruas Rome:

Përmirësimi i statusit të gruas Rome në familje dhe shoqëri.

Që prej themelimit të saj, qendra ka zhvilluar aktivitete të ndryshme që synojnë fuqizimin e gruas Rome si:

- Ndërgjegjesimin mbi rolin e rëndësishëm që grua luan në familje e shoqëri;
- Promovimin e barazisë gjinore;
- Krijimin e lidershit të gruas Rome dhe rritjen e pjesëmarrjes së saj në vendim marrje;
- Ngritjen e një rrjeti të grave aktiviste Rome në të gjithë Shqipërinë.

“Bashkëpunimi dhe koordinimi i punës me organizatat e tjera, do të përshpejtojë përmbushjen e misionit që ne si organizata kemi, respektimin e të drejtave të minoritetit Rom dhe përmirësimin e situatës social-politiko-ekonomike të tij. Besoj se nëpërmjet punës advokuese të përbashkët, në të ardhmen, do të kemi me shumë mundësi të ndikojmë politikën dhe të marrim pjesë në proceset vendimmarrëse”.

Manjola VEIZI

Drejtoresh Ekzekutive

“Qendra për të Drejtat e Gruas Rome”

m_veizi@yahoo.com

“Roma Woman Rights Centre “ is a non-profit, non-governmental center founded on November 2012 by a group of women activists.

The mission of the Roma Woman Rights Centre:

Improving the status of Roma woman in family and society.

Since its establishment, the centre has developed various activities aimed at empowerment of Roma woman:

- Awareness about the important role of woman in family and society;
- Promotion of gender equality;
- Promotion of Roma women's leadership and their participation in decision making;
- Establishment of a network of Roma women activists in Albania.

“The Collaboration and the coordination of the work with other organizations will accelerate the fulfilment of the mission that we as organizations have, respecting the rights of Roma and improving the socio-politic-economic situation. I believe that through a joint advocacy work we will achieve to have more possibilities to influence the policies and to participate in decision making processes in the future”.

Manjola VEIZI

Executive Director

“Roma Woman Rights Centre”

m_veizi@yahoo.com



Adresa: Rruga "Pandi Raidhi" L4, Korçë

Tel/Fax: +35582244212

Mobile: +355692258349

E-mail: arbenkosturi@yahoo.co.uk

Web: www.disutni-albania.webs.com

Disutni Albania

Shoqata "Disutni Albania" Korçë, megjithëse u themelua që në vitin 1995, u regjistrua si person juridik më 25 Janar 2002.

Qëllimi i shoqatës:

"Zhvillimi dhe përhapja e kulturës, artit, traditave të Romëve; emancipimi arsimor dhe kulturor i Romëve; lufta kundër analfabetizmit; si dhe mbrojtja e të drejtave të komunitetit Rom, duke i shfaqur në mediat lokale dhe kombëtare.

Fokusi i punës së shoqatës "Disutni Albania":

- Arsimimi dhe formimi i përgjithshëm profesional i të rinjve Romë;
- Mbështetja dhe forcimi i arritjeve të Romëve në fushat e letërsisë, muzikës, artit të thuprës, punës me dorë dhe artizanatit.
- Përhapja e njohurive mbi Romët, nëpërmjet botimeve në gjuhë të ndryshme;
- Bashkëpunimi me muzetë dhe qendrat e tjera të Romologjisë në botë.

Disa prej aktiviteteve të shoqatës "Disutni Albania" janë: organizmi i konferencave të ndryshme, workshopeve me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar, kushtuar problemeve dhe zhvillimit të gjuhës dhe kulturës Rome. Shoqata "Disutni Albania" ka realizuar emisionin e parë televiziv në dy gjuhë Shqip dhe Romisht "Bashkejtesë dhe Integrim". Nëpërmjet këtij emisioni, janë vënë në pah vlerat, kultura tradita, gjuha, doket dhe zakonet e këtij minoriteti, dhe nga ana tjetër janë trajtuar problemet që ky minoritet has në jetën e përditshme. Shoqata ka ofruar trajnime të ndryshme për gazetari, operatore dhe teknike montazhi për të rinj të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në disa qytete të Shqipërisë. Shoqata "Disutni Albania" pavarësisht arritjeve, kërkon mbështetje dhe bashkëpunim me shoqatat dhe organizatat e tjera të cilat ndihmojnë në përmirësimin e kushteve të minoritetit Rom.

"Të jesh pjesë e këtij rrjeti, do të thotë të jesh më afër zgjidhjes së problemeve të këtij komuniteti, duke i mbështetur dhe thënë që të gjithë jemi një dhe veprojmë për një qëllim të përbashkët"

Arben Kosturi

Drejtor Ekzekutiv

Shoqatës "Disutni Albania, Korçë

The association "Disutni Albania" Korçë, although it was established on March 1995, it was registered as a legal entity on 25 January 2002.

The aim of the association:

"Development and dissemination of culture, art, traditions of Roma; educational and cultural emancipation of Roma; support against illiteracy and protection of Roma community rights through broad casting them in the local and national media.

The focus of "Disutni Albania" association

- Educational support and profesional training for Roma youths;
- Supporting and strengthening Roma achievements in literature, music, art and handicrafts;
- Spreading information for Roma minority through publications in different languages;
- Collaboration with museums and other centers of Romology in the world.

Some of the "Disutni Albania" association activities are: the organization of conferences, workshops and (national and international) focused on the problems and the development of the Roma language and culture. The association "Disutni Albania" has realized the first TV program in English and Roma languages "Coexistence and Integration". Through this program, the values, the culture, the traditions, the language, the habits and customs of the community are highlighted, and on the other side, daily problems faced by this minority are addressed. The association has provided training opportunities (journalism, operator and technical editing) for the Roma and Egyptian youths in different cities of Albania. The associations "Disutni Albania" despite its positive achievements needs support and cooperation with other associations or organizations for improving the living conditions of Roma minority in Albania.

"Being part of this network, means to be closer to community for solving their problems through supporting them; we are one and act for a common purpose"

Arben Kosturi

Executive Director

The association "Disutni Albania", Korça



I Romni e Tasjaraqi

Gruaja Rome e së Nesërmeres

Shoqata "I Romni e Tasjaraqi" ("Gruaja Rome e së nesërmeres") është krijuar më 20 Maj 2003 si një organizatë jo-fitimprurëse, jo-qeveritare. Kjo shoqatë e ka qendrën në Tiranë, por aktiviteti i saj është i shtrirë edhe në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë.

Qëllimi i shoqatës:

Realizimi i aktiviteteve sociale, kulturore, arsimore pranë komunitetit Rom, me programe dhe tematika të fokusuara kryesisht në përmirësimin e nivelit kulturor e arsimor të fëmijëve parashkollorë Rom; ndërgjegjësim dhe sensibilizim në edukim dhe arsimim (sidomos në ato familje ku mbizotëron analfabetizmi).

Disa nga aktivitetet e organizuara:

Aktivitetet e kësaj shoqate kanë filluar me krijimin e Forumit të Gruas Rome, në bashkëpunim me Unionin "Amaro Drom". Më pas ka realizuar mjaft aktivitete kulturore, arsimore, sociale me familjet Rome, fushata ndërgjegjësimi mbi të drejtat e grave, shëndetit të gruas, aktivitete kundër analabetizmit, trajnime, workshope me të rinjtë etj. Këto aktivitete janë realizuar kryesisht në Tiranë, por dhe nëpër rrethet e ndryshme në Shqipëri (Berat, Fier, Fushë-Krujë, Elbasan, Korçë). Shoqata "Gruaja Rome e së Nesërmeres" ka qënë vazhdimisht mbartëse e ideve dhe vizioneve të reja, të cilat lindin si domosdoshmëri e kohës dhe integritetit të shoqërisë shqiptare në familjen e madhe Evropiane. Shoqata "Gruaja Rome e Së Nesërmeres" bashkëpunon ngushtësisht me institucionet shtetërore dhe organizatat tjera të shoqërisë civile, duke dhënë një kontribut të vlefshëm për minoritetin Rom. Bashkëpunetorë të shoqatës janë specialistëve të fushave të ndryshme (mësues, edukatorë, punonjës social, jurist, artistë etj).

"Besoj se duke qënë të bashkuar, do jemi pjesë e vendimarrjes duke ngritur lart zërin e minoritetit Rom dhe forcuar pozicionin e grave Rome, për të gjetur një zgjidhje për problemet e tyre"

Meleqe Rrenja

Kryetare shoqate
I Romni e Tasjaraqi
meleqerrenja@yahoo.com

Roma Woman of Tomorrow

The association "I Romni e Tasjaraqi" (Roma Woman of Tomorrow) was established on 20 May 2003 as a non-profit, non-governmental association. This association's headquarter is in Tirana, but it operates also in some other cities of Albania.

The aim of the association is:

The organizational of social, cultural, educational activities, with programs focused mainly on improving educational and cultural level of Roma children, preschool education; awareness and sensitization in education (especially in those families where the illiteracy dominates).

Some of the organized activities:

The activities of this association started with the establishment of Roma Women's Forum, in collaboration with "Amaro Drom" Union. There were realized different cultural, educational, activities with Roma families, awareness campaigns on women's rights, women's health, activities against illiteracy, trainings, workshops with youths etc. These activities were organized mostly in Tirana but also in different cities in Albania (Berat, Fier, Fushë-Krujë, Elbasan, Korçë). The association "Roma woman of tomorrow" has always been focused in new ideas and visions, which arise as a necessity of time and contribute to the integration of Albanian society into the big European family. The association "Roma woman of tomorrow" cooperates closely with governmental institutions and other organizations of civil society, giving a valuable contribution for Roma community. Collaborators of the association are specialists from different fields such as teachers, educators, social workers, lawyers, artist etc.

"I believe that being united, we will be part of the decision making, to raise up the voice of Roma and strengthen the position of Roma women to find a solution for their problems"

Meleqe Rrenja

Chair
I Romni e Tasjaraqi
meleqerrenja@yahoo.com



Romano Sezi, Elbasan

“Romano Sezi” është një shoqatë jo qeveritare, jo fitimprurese, e krijuar në 2 Nëntor 2007 me qendër në Elbasan.

Misioni:

Përmirësimi i kushteve të jetesës së minoritetit Rom nëpërmjet promovimit të integritetit social, ekonomik dhe mbrojtjes së identitetit.

Eksperiencat dhe programet që ndiqen nga kjo organizatë janë:

- Fushata ndërgjegjësuere për ngritjen e nivelit arsimor të fëmijëve Rom;
- Aktivitete sportive me të rinjtë Rom;
- Kampe verore për fëmijët Rom;
- Advokim me partnerët lokal për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit Rom në Elbasan;
- Rregjistrim civil për komunitetet Romë dhe Egjiptian në Elbasan, Peqin dhe Cërrik;
- Projekt në infrastrukturë.

Shoqata Romano Sezi bashkëpunon ngushtësisht me partneret lokal dhe është një aktor i rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit Rom në rajonin e Elbasanit (me organizata jo qeveritare dhe institucione të pushtetit lokal).

“Besojmë tek ky rrjet, pasi së bashku, mund të mbrojmë identitetin e minoritetit Rom në Shqipëri”

Enver Mustafaj

Kryetar Shoqate
Romano Sezi

“Romano Sezi” is a non-governmental, non-profit association, established on 2 November 2007, with its headquarter in Elbasan.

The mission

Improving the living conditions of Roma through the promotion of social-economic integration and the protection of the identity.

Experiences and programs of the association:

- Awareness campaigns to raise the level of education of Roma children;
- Youth sports activities for Roma ;
- Summer camps for Roma children;
- Advocacy with local partners for the protection of the Roma rights in Elbasan;
- Civil registration for Roma and Egyptian communities in Elbasan, Peqin and Cërrik;
- Infrastructure Projects;

The association “Romano Sezi” cooperates closely with local partners and it is an important actor for the protection of Roma rights in Elbasan region (with non-governmental organizations and local government institutions).

“We believe in this network, because together, we can protect the identity of Roma minority in Albania”

Enver Mustafaj

Chair
Romano Sezi



Voice of Roma in Albania

Adresa: Baltëz, Ndërmenas, Fier, Shqipëri.

“Voice of Roma in Albania” është një shoqatë jo qeveritare e cila është themeluar në 26 Dhjetor 2012.

Qëllimi i shoqatës “Voice of Roma in Albania”:

Nxitja e zhvillimit social dhe ekonomik të komunitetit Rom dhe integrimi i tyre si të barabartë në shoqërinë shqiptare, nëpërmjet fuqizimit të të rinjve, ngritjes së zërit Rom pranë autoriteteve publike në fushën e arsimit, punësimit, shëndetësisë, strehimit si dhe të ndihmojë respektimin dhe përmbushjen e të drejtave të komunitetit Rom.

Ndër aktivitetet më të rëndësishme që ka realizuar organizata janë;

- **Policimi në Komuniteti**, projekt i cili është zbatuar në fshatin Baltëz, Fier dhe ka patur si synim nxitjen e bashkëpunimit të minoritetit Rom me policinë e shtetit.
- **Projekt mbi fuqizimin dhe mobilizimin e komunitetit Rom/Egjyptian për të përfituar shërbime publike, Lushnje.**
- **Ndërgjegjësimi për rëndësinë e edukimit të fëmijëve dhe të rinjve Rom në zonën e Novoselës, Vlorë.**

“Së bashku me të tjerë të rinj Rom, organizata të tjera Rome, do të punojmë fuqishëm për të ndryshuar situatën e minoritetit Rom në Shqipëri”

Fatos Koçi

Drejtor Ekzekutiv
Voice of Roma in Albania

“Voice of Roma in Albania” is a non-governmental association which was founded on 26 December 2012.

The aim of the association “Voice of Roma in Albania”

Promoting social and economic development of Roma and their integration as equals in Albanian society through youth empowerment, raising Roma voice at public authorities in the field of education, employment, health, housing, in order to respect and fulfill the rights of Roma community.

The most important organized activities

- The project “Community Policing” is implemented in the village of Baltez, Fier aiming and promoting the cooperation of Roma with the state police.
- Project on strengthening and mobilizing the Roma and Egyptian community to obtain public services, in Lushnje.
- Awareness about the importance of children and young Roma education in the area of Novosela, Vlore.

“Together with other Roma youths, other Roma organizations, we will work hard to change the situation of Roma minority in Albania”

Fatos Koçi

Executive Director
Voice of Roma in Albania



“Realiteti i Romëve në Shqipëri” (CERA), Pogradec

“Realiteti i Romëve në Shqipëri” (CERA) është një shoqatë jo qeveritare, jo fitimprurëse e cila është themeluar më datë 30 Tetor 2012 dhe vepron në Pogradec.

Qëllimi i shoqatës:

- Të kryejë veprimtari të ndryshme, në të mirë të komunitetit Rom, (veprimtari të cilat ndalojnë diskriminimin e këtij komuniteti);
- Të kryejë veprimtari të cilat ndalojnë braktisjen e shkollave nga komuniteti Rom;
- Të ndihmojë familjet Rome në nevojë;
- Të krijojë mundësi dhe nxitje punësimi për të rinjtë Rom, nëpërmjet ndjekjes së kurseve të ndryshme profesionale.
- Të ofrojë trajnime të ndryshme për të rinjtë Rom, gratë e divorcuara, të dhunuara apo me probleme sociale.
- Të orientojë dhe ndihmojë të rinjtë Rom për të aplikuar për bursa të ndryshme studimi.

“Të jemi sa më të bashkuar për të mirën e këtij komuniteti”

Lumturi Ali

Krytare Shoqate

“Realiteti i Romëve në Shqipëri” (CERA), Pogradec
ceraalb@yahoo.com

“The Reality of Roma in Albania” (CERA) is a non-governmental, non-profit association which was established on 30 October 2012 and operates in Pogradec.

The aim of the association:

- To carry out various activities for Roma community (activities that stop discrimination of this community);
- To conduct activities that stop the dropping out of Roma in the schools;
- To assist the Roma families in need;
- To create opportunities and employment incentive for youths to follow different professional courses;
- To provide training opportunities for young Roma women, divorced, abused or with social problems;
- To orient and help Roma youths to apply or study for various scholarships.

“To be more united for the good of the community”

Lumturi Ali

Chair

“Reality of Rom in Albania” (CERA), Pogradec
ceraalb@yahoo.com



Shoqata “Shpresë për të varfërit”

Lezhë / Shqipëri

Shoqata “**Shpresë për të varfërit**” që punon me shtresat e popullatës në nevojë, është themeluar më datë 09 Dhjetor 1996, me veprimtari në Lezhë.

The association “**Hope for the poor**” which works with people in need was established on December 9th, 1996 and operates in Lezha.

Misioni i shoqatës:

- Largimi i fëmijëve Rom dhe Egjyptian nga rruga dhe mbrojtja e tyre nga fenomene si trafikimi i qënieve njerëzore (fëmijet), droga (lëndet narkotike) dhe abuzimet seksuale;
- Organizimi i familjeve në nevojë në drejtim të edukimit të fëmijëve të tyre;
- Ndihma të ndryshme me motive sociale për familjet në nevojë dhe kategoritë e njerëzve siç janë invalidet dhe persona të pa aftë të komunitetit.

The mission

- Removal of Roma and Egyptian children from the streets and protecting them from the phenomenon of human being trafficking (children), drugs (narcotic drugs) and sexual abuse;
- Organizing the families in need to educate their children;
- Different social assistance for the families in need and the categories of people such as invalids and disabled people in the community.

Disa nga projektet e shoqatës :

- “Edhe ne jemi pjesë e Komunitetit Qytetar” (1997);
- “Të argetohemi për t’u edukuar”(1999-2000);
- “Aktivitet kulturor artistik” (2009-2010);
- “Largimi nga rruga i fëmijëve të varfër të popullsisë Egjyptiane dhe Rome dhe intergrimi i tyre në shkollë” (2002-2014).

Some of the association projects:

- “We are part of the Citizen Community “ (1997);
- “To entertain for being educated “ (1999-2000);
- “Artistic and cultural activities” (2009-2010);
- “Removing the poorest Roma and Egyptian children from the street and integrate them in school” (2002-2014).

“Bashkëpunim sa më eficient për t’i shërbyer komunitetit”

“Efficient collaboration to better serve to the community”

Rauf Selimi

Kryetar Shoqate

Shoqata “Shpresë për të varfërit”

E-mail: raufselimi@hotmail.com

Rauf Selimi

Chair

“Hope for the Poor”

E-mail: raufselimi@hotmail.com



Integrimi Rinor Komunitar

Integrimi Rinor Komunitar është një shoqatë jofitimprurëse e cila është themeluar më datë 9 Dhjetor 2013 dhe vepron në rajonin e Korçës.

Qëllimi i shoqatës:

- Ndhimë dhe asistencë ndaj komunitetit Rom dhe Egjiptian në nevojë në rajonin e Korçës;
- Trajnime për të rinjtë e këtyre komuniteteve në fushën sociale dhe kulturore;
- Ndërgjegjësim për jetimet, fëmijet e rrugës, fëmijë të braktisur etj;
- Mbështetje për grupet sociale pa përkrahje, për t'i integruar në jetën e komunitetit të tyre;
- Rritja e besimit për jetën dhe shoqërinë në komunitetet Rome dhe Egjiptiane që nuk kanë mbështetje.

Disa nga aktivitetet më të rëndësishme që ka realizuar organizata;

- Fuqizimi i të rinjve Rom dhe Egjiptian në vendimarrje, ngritja e kapaciteteve të antarëve të komunitetit për të lobuar me institucionet vendore.
- Trajnime të ndryshme, workshope për identifikimin dhe punësimin e të rinjëve Rom dhe Egjiptian.

“Për një bashkëpunim të fortë, për t'i ardhur më shpejt në ndihmë personave në nevojë, sepse bashkimi bën fuqinë”

Muhamet Rapi

Kryetar Shoqate
Integrimi Rinor Komunitar
Integrimirinorkomunitar1@gmail.com

Community Youth Integration is a non-profit association that was established on 9 December 2013 and operates in Korça region.

The aim of the association:

- To help and assist Roma and Egyptian communities in Korça region;
- To conduct trainings in social and cultural fields for youths;
- To rise awareness campaigns for orphans, abandoned children, etc;
- To support the disadvantaged social groups, to integrate them into the society;
- To increase the confidence in life and society for Roma and Egyptian communities.

Some of the most important activities organized;

- Strengthening Roma and Egyptian youth in decision makings, increasing the capacity of the community members to lobby with the local institutions.
- Conducting various trainings, workshops for the employment of Roma and Egyptian youths.

“For a strong cooperation, to faster help the people in need, because the unity is power”

Muhamet Rapi

Chair
Community Youth Integration
Integrimirinorkomunitar1@gmail.com



Shoqata “Vllazëria Egjiptiane” Pogradec

“**Vllazëria Egjiptiane**” është një shoqatë e cila është themeluar me datë 09 Shkurt 2013.

Misioni

Mbështetja e komuniteteve vulnerabel në fushën e edukimit, punësimit, strehimit dhe mos diskriminimit; ruajtjen dhe promovimin e vlerave dhe traditave kulturore të komuniteteve si dhe ruajtjen e mjedisit.

Disa nga aktivitetet e shoqatës “Vllazëria Egjiptiane” janë: ndërgjegjësim mbi mbajtjen pastër të mjedisit (pastrimi i bregut të liqenit të Ohrit në ditën ndërkombëtare të mjedisit), aktivitete mbi fuqizimin e grave Rome dhe Egjiptiane, ndërgjegjësim mbi të drejtat e punësimit, si dhe shumë aktivitete sensibilizuese për dhunën në familje, dhunën ndaj grave, të drejtat e fëmijëve, mbi të drejtat e njeriut etj. Shoqata “Vllazëria Egjiptiane” ka qenë pjesmarrese në shumë panairë duke ekspozuar vlerat dhe traditat e komunitetit Egjiptian.

“Për një mbrojtje më të mirë të të drejtave të grupeve vulnerabel”

Agron Lamçe

Kryetar Shoqate
Shoqata “Vllazëria Egjiptiane”
shpetimdute@gmail.com

“**Egyptian Brotherhood**” is an association which was established on 09 February 2013.

The mission

Supporting the vulnerable communities in education, employment, housing and non-discrimination; protection and promotion of communities’ cultural values and traditions; environmental protection.

Some of the “Egyptian Brotherhood” association activities are: various volunteer activities such as awareness campaigns about environment protection (cleaning the coasts of the Ohrid Lake in the international environment day), activities on empowering Roma and Egyptian women, awareness against domestic violence, women violence as well as many activities on employment rights, children’s rights, human rights etc. The “Egyptian Brotherhood” association has been participated in many fairs, promoting the values and the traditions of the Egyptian community.

“For a better protection of the vulnerable group rights”

Agron Lamçe

Chair
Shoqata “Vllazëria Egjiptiane”
shpetimdute@gmail.com



Shoqata Rome dhe Egjyptiane “ALEANCA PËR INTEGRIM EUROPIAN”

Adresa: Rr.Niko Avrami” nr 21-Tirane.

Shoqata Rome dhe Egjyptiane “**Aleanca për Integrim European**” është një organizatë jo-qeveritare, jo-fitimprurëse, e pavarur, jo politike. Kjo shoqatë është themeluar më 18 Mars 2013.

Misioni

Integrimi i komunitetit Rom dhe Egjyptian nëpërmjet arsimimit, punësimit, dhe ndërgjegjësimit.

Kjo shoqatë ka organizuar aktivitete të ndryshme, ndër të cilat është edhe shpërndarja e disa ndihmave ushqimore dhe veshmbathjesh për banorët e komunitetit të Bregut të Lumit.

“Mendoj se duke u bashkuar dhe vepruar me një zë të vetëm, procesi i integrimit të komunitetit Rom dhe Egjyptian do jetë më i shpejtë dhe më rezultativ”

Suela QELIBARI

Kryetare Shoqate

Shoqata Rome dhe Egjyptiane

“Aleanca për Integrim European”

E-mail: aleanca.i.e@gmail.com

Roma and Egyptian Association, “**The Alliance for the European Integration**”, is a non-governmental, non-profit, independent and non-political association. This association was established on 18 March 2013.

Mission

Integration of Roma and Egyptian communities through education, employment and awareness rising.

This association has organized various activities, among others, assistance on distributing food and clothing for the community members of “Bregu i Lumit”.

“I think that being united and act as one voice, the process of integration of Roma and Egyptian communities will be faster and effective”

Suela QELIBARI

Chair


Roma and Egyptian Association

“The Alliance for the European Integration”

E-mail: aleanca.i.e@gmail.com

**KRIJIMI I RRJETIT KOMBËTAR TË ORGANIZATAVE
ROME / EGJYPTIANE**

**ESTABLISHMENT OF NATIONAL NETWORK OF
ROMA / EGYPTIAN ORGANIZATIONS IN ALBANIA**



Më datë 18 Qershor 2014, Unioni "Amaro-Drom" zhvilloi takimin e parë për krijimin e Rrjetit Kombëtar Rom/Egjiptian me përfaqësues të organizatave Rome/Egjiptiane dhe aktivistë të cilët punojnë për përmirësimin e jetesës së komunitetit Rom/Egjiptian në Shqipëri.

Në këtë takim morën pjesë 8 përfaqësues të organizatave Rome/Egjiptian nga qytete të ndryshme të Shqipërisë dhe 24 aktivistë.

Takimi nisi me fjalën përshëndetëse të **Z. Skënder Veliu**, Drejtor Ekzekutiv i Unionit për Zhvillimin dhe Integrimin e Minoritetit Rom në Shqipëri "Amaro Drom" i cili pasi i falenderoi të pranishmit për prezencën e tyre, shpjegoi qëllimin e takimit. Gjatë fjalës së tij ai u ndal tek "Alternativat në vite" të Unionit Amaro-Drom, "Lëvizjen Rome", iniciativat e marra dhe projektet e realizuara me sukses.

Pas prezantimit të Z. Veliu, fjalën e mori **Znj. Anisa Mema**, koordinatore projekti e cili prezantoi një draft strategji për rrjetin, misionin, vizionin, kriteret e pjesëmarrjes dhe aplikimit, qëndrueshmëria e rrjetit dhe organizimin e takimeve. Sic ajo e përmendi, ky është takimi i parë dhe shpresohet të dalin rekomandime të vlefshme nga aktorë të ndryshëm që janë prezentë (aktivistë, organizata etj). Unioni Amaro-Drom do të bëjë përpjekjet maksimale që ky rrjet të jetë funksional në dobi të minoritetit Rom/Egjiptian në Shqipëri.

Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, Z. Alket Jaupi dhe Znj. Ilda Bozo, Drejtore e Drejtorisë për Përfshirjen Sociale dhe Barazinë Gjinore, Ministria e Mirqënies Sociale dhe Rinisë, shprehën mbështetjen dhe angazhimin e tyre për këtë rrjet. Ata e përshëndetën iniciativën e "Amaro-Drom" për krijimin e rrjetit kombëtar Rom/Egjiptian duke e cilësuar këtë takim shumë të mirëorganizuar. Disa prej rekomandimeve që ata nënvizuan ishin:

- Është e nevojshme që të ketë një përfaqësi cilësore të minoritetit Rom/Egjiptian, që të përballet fort në mënyrë demokratike me institucionet shtetërore;
- Aktivizimi i të rinjve Romë/Egjiptian është shumë i rëndësishëm për t'u përfshirë;
- Organizatat e përfshira në rrjet duhet të kenë të drejta të barabarta;
- Rrjeti të funksionojë mbi bazën e një bordi, ku të zgjidhet një kryetar me votim.

On 18.06.2014 "Amaro-Drom" Union organized the meeting for the establishment of Roma/Egyptian national-wide network with representatives of Roma/Egyptian organisations and activists working for the improvement of livelihood of Roma/Egyptian communities in Albania.

8 representatives from different Roma/Egyptian organisations in Albania and 24 activists participated in this meeting.

The meeting was opened by **Mr. Skender Veliu**, Executive Director of Union for "Development and Integration of Roma minority in Albania "Amaro Drom" who thanked the participants for their presence and explained the purpose of this meeting. The establishment of this network is based on the project "Sustainable improvement of livelihood of Roma communities in Albania". During his speech he presented "Amaro-Drom" alternatives in years, "Roma movement", different initiatives and successful projects realized.

The project coordinator Ms. Anisa Mema presented a draft network strategy, the mission, the vision, participation criteria, network sustainability and future meetings. As she said, this is the first network meeting and the necessary recommendation from different actors (organizations, activists etc) will be considered in this strategy. Amaro-Drom Union will make the maximal efforts to make this network operational and functional.

The representatives of Ombudsman Mr. Alket Jaupi and Mrs. Ilda Bozo, Director in monitoring directory of cross-cutting strategy, Ministry of Social Welfare and Youth, who were invited in this activity, expressed their support and commitment for this network. They welcomed the initiative of "Amaro – Drom" considering this activity very well organized. As they emphasized:

- It is necessary to have a qualitative representation of Roma/Egyptian communities in Albania, to make strong democratic confronts with the government institutions for considering their rights.
- Roma/Egyptian youth activism is very important to be included.
- Organizations involved in the network must have equal rights.
- The network must function based on a board, where the president should be chosen by vote.

Gjatë pjesës së dytë të takimit, pjesëmarrësit patën mundësi të përcillnin eksperiencat e tyre në punën me komunitetin Rom/Egjiptian duke dhënë dhe opinionin e tyre rreth krijimit të Rrjetit Kombëtar Rom/Egjiptian. Disa prej pjesëmarrësve, ishin skeptik në lidhje me krijimin e këtij rrjeti. Pothuajse të gjithë këta antarë skeptik, kanë qenë pjesë edhe e rrjeteve të tjera, të cilat kanë rezultuar të pasukseshme. Ata ndihen të zhgënjyer, pasi ata mendojnë se përgjithësisht nuk janë menaxhuar dhe përmbushur misionet për të cilat këto rrjete janë krijuar.

During the second part of this activity, the participants had the opportunity to share their working experiences with Roma community. They gave their opinions about the establishment of Roma/Egyptian national network. Some participants were skeptic about the establishment of this network. Almost all of them have been part of other networks. They are disappointed with these networks because, they think they were not managed as well as to fulfill their missions for which they were created.



Z. Velu sqaroi se, ky është takimi i parë dhe qëllimi është për të krijuar këtë iniciativë së bashku, ne jemi duke vlerësuar dhe duke marrë në konsideratë çdo ide për mirëorganizimin e këtij rrjeti. Ky rrjet nuk ka të bëjë me iniciativë të mëparshme. Gjatë aktivitetit, nga koordinatori e projektit u shpjeguan mënyrat e aplikimit në rrjet (formulari i aplikimit) dhe memorandumit i bashkëpunimit i prezantuar nga Znj Albana Paloka, juriste pranë Unionit "Amaro-Drom". Në fund të aktivitetit, përfaqësuesit e organizatave të ndryshme Rome dhe aktivistët nënshkruan memorandumit e bashkëpunimit. Memorandumit mbetet i hapur, për organizatat e tjera që kanë nevojë për kohë për të marrë në shqyrtim pjesëmarrjen në këtë rrjet dhe për organizatat që nuk kanë qenë pjesë e këtij aktiviteti.

Mr. Velu explained that this is the first network meeting and the purpose is to establish this initiative, we are evaluating and taking into consideration every idea for better organizing this network. This network has not to do with other initiatives.

During the activity were explained also the application form, by the project coordinator and the memorandum of collaboration by the lower of Amaro-Drom Ms. Albana Paloka. At the end of the activity, 8 representatives of different Roma/Egyptian organizations and 18 activists signed the memorandum of collaboration. The memorandum remains open for other organizations that need time to consider the participation in this network and for organizations that were not able to participate during this activity.

Takimi i 2-të i rrjetit

Më 12 Dhjetor 2014 u organizua takimi i 2të i Rrjetit Kombëtar të Organizatave Rome/Egjyptiane "Së bashku për forcimin e zërit Rom/Egjyptian në Shqipëri". Qëllimi i këtij takimi ishte ndarja e informacionit mes organizatave dhe ndërmarrja e iniciativave në dobi të minoritetit Rome / Egjyptian në nivel kombëtar. Pjesmarres në takim ishin organizata Rome dhe Egjyptiane.

Takimi u hap nga Z. Skënder Veliu, i cili falenderoi të gjitha organizatat të cilat janë aktive dhe kanë ndihmuar në ngritjen e zërit Rom/Egjyptian dhe nënvizoi rëndësinë e të qenit të bashkuar për të arritur progres. Është shumë e rëndësishme pjesëmarrja në rrjet pasi, duhet të ketë shpërndarje informacioni dhe në fund të takimeve të ketë rezultate konkrete. Rrjeti përbëhet nga specialiste të ndryshëm, të cilët mund të japin kontributin e tyre në fusha të ndryshme (juridike, sociale, kulturore etj).

2nd network meeting

On 12 December 2014 it was organized the II meeting of the national network of Roma/Egyptian organizations "Together for strengthening the voice of Roma / Egyptian in Albania". The purpose of this meeting was sharing of information between organizations and initiating initiatives in favor of Roma/ Egyptian in national level.

The meeting was opened by Mr. Skender Veliu, who thanked all the organizations which are active and have helped in raising the voice of Roma/Egyptian and underlined the importance of being united. The participation in the network is very important because the information should be disseminated and the meetings should have concrete results. The network is composed by different specialists who can contribute in different areas (legal, social, cultural, etc).



Disa nga çështjet që u diskutuan ishin:

- **Futja e kulturës dhe traditës Rome në kurrikulat e shkollës.** Sipas Z. Sead Kazanxhiu/Artist vizual ka ardhur koha të bëjmë dicka për veten. Nuk duhet të mbetemi në nivel diskutimesh, por të arrijmë të japim zgjidhje konkrete. Ai sygjeroi që të ngrihet një grup pune në mënyrë që të krijohen disa struktura e strategji nëpërmjet të cilave të punohet. Përfshirja e kulturës Rome në kurrikulat e shkollës është shumë e rëndësishme. Fëmijet Rom dhe jo Rom do të kenë mundësi të mësojnë kulturën dhe historinë Rome. Z. Veliu theksoi rëndësinë e kujdesit ndaj historisë Rome, pasi ka rrezik asimilimi i saj.

Some of the issues discussed:

- **The inclusion of Roma culture and traditions in the school curriculum.** According to Mr. Sead Kazanxhiu/visual artist, it is the time to do something for ourselves. We need to come out with concrete solutions rather than remaining at the discussions. He suggested to set-up a working group in order to create some structures and strategies to work. The inclusion of Roma culture in the school curriculum is very important. Roma and non-Roma children will have the opportunity to learn the culture and history of Roma. Mr. Veliu emphasized the importance of conservation

Sipas tij duhet të krijohet një dosje me dokumentat e nevojshme e argumenta bindese mbi rëndësinë e kësaj nisme dhe t'i delegohet ministrive përkatese. Romët kanë abetaren, gramatiken dhe fonotiken e tyre.

- Krijimi i historisë së shkruar Rome

- Forcimi i statusit të gruas Rome dhe Egjiptiane (të ndërhyet me fushata ndërgjegjësimi për të shmangur dhunën ndaj garve, mentalitetin, martesat e hershme etj).

- Kërkimi i statusit minoritet Rom. (Sipas pjesmarrësve, nevojiten informacione se ku mund të ndërhyet me iniciativat e ndërmarra. Puna e rrjetit duhet të fillojë nga të drejtat tek komisioni i ligjeve në parlament.)

- Të realizohet censusi për Romët. (Ne duhet të krijojmë statistika, duhen ndërmarrë inisiativa konkrete, duhet bërë regjistrimi i antarëve të komunitetit).

- Të ndërmeren iniciativa për legalizimin e barkave apo ndërtesave të komunitetit.

- Problematik mbetet punësimi i të rinjëve të cilët kanë përfunduar kurset profesionale (nevojitet shkëmbim informacioni, për të ndihmuar të rinjtë Rom dhe Egjiptian, të punësohen dhe eksplorimi i tregut të punës).

- Informim mbi rastin e dëbimit nga banesat sociale, për familjet Rome dhe Egjiptiane në Korçë.

- Ndarje dhe shkëmbim eksperiencash nga secila organizatë.

- Legalizimi i banesave dhe rikonstruksioni i banesave.

- Forcimi i bashkëpunimit me institucionet e pushtetit lokal dhe qendror (Sipas pjesmarrësve, me pushtetin lokal marrëdhëniet janë bashkëpunuese).

- Informimi publik mbi krijimin e këtij rrjeti (informimi i institucioneve qeveritare qendrore dhe lokale).

- Mbledhja e të dhënave, për të ndërtuar profilin e secilës organizatë.

of Roma history because there is the risk of assimilation. A folder with documents should be created and addressed to the relevant ministries. Roma have their alphabet, grammar and phonetics.

- Establishing the written history of Roma

- Strengthening the status of Roma and Egyptian women, (awareness campaigns to end violence against women, mentality, early marriages, etc).

- The status of the Roma minority. (According to participants, its needed information on where to intervene with the undertaken initiatives. The work of the network must start from the rights to the commission of laws in the parliament).

- The census for Roma. (We need to create statistics, to undertake concrete initiatives; to register the community members).

- To undertake initiatives for the legalization of barackes or community buildings.

- The employment of young people who have completed vocational courses (it is required the exchange of information to help young Roma and Egyptian and to explore the labor market).

- Sharing information about the case of Roma and Egyptian families in Korça evicted from their social housing.

- Exchanging experiences among organization.

- Legalization of houses and house reconstruction.

- Strengthening the cooperation with local and central government institutions.

- Public information on the creation of this network (informing the central and local government institutions).

- Collecting data to build the profile of each organization.

Takimi i 2^{të} i rrjetit

2nd network meeting

WORKSHOP “TË DREJTAT E MINORITETIT ROM”

WORKSHOP ON “THE RIGHTS OF ROMA MINORITY”

>> >> >> 5

Rrjeti kombëtar i organizatave Rome/Egjyptiane "Së bashku për forcimin e zërit Rom/ Egjyptianë në Shqipëri" në 21 Tetor 2014, në Tiranë organizoi workshopin "Të drejtat e minoritetit Rom në Shqipëri". Qëllimi i këtij workshopi ishte njohja e pjesmarrësve me bazën ligjore, politikat që shërbejnë në mbrojtje të minoritetit Rom në Shqipëri, iniciativa konkrete të ndërmarra duke lobuar dhe advokuar. Pjesmarrës në këtë workshop ishin përfaqësues të avokatit të popullit, përfaqësues nga zyra e komisionerit për anti-diskriminim, drejtoresha ekzekutive e Grupit Shqiptar të të Drejtave të Njeriut, drejtoresha ekzekutive e Komitetit shqiptar të Helsinkit si dhe përfaqësues të rrjetit kombëtar Rom/Egjyptian. Workshopi u organizua i ndarë në tre sesione (Sesioni i I- Minoriteti Rom dhe Kuadri ligjor; Sesioni i II-Lobimi dhe Advokimi; Sesioni i III- Veprimet për të ardhmen). Workshopi në përgjithësi ishte gjithëpërfshirës, të gjithë pjesëmarrësit u inkurajuan për të sjellë kontributin e tyre, të diskutonin mbi temat dhe të jepnin mendimin e tyre.

Komisioneri i Avokati i Popullit **Z. Ermir Kapedani** theksoi se institucioni i Avokatit të Popullit është një institucion kushtetues dhe ka pasur gjithmonë në vëmendjen e tij minoritetin Rom në Shqipëri. Ata janë një pakicë e marginalizuar, por kanë vëmendjen e të gjithë institucioneve ndërkombëtare. Z. Kapedani paraqiti disa rekomandime të cilat Avokati i Popullit i ka dërguar institucioneve përgjegjëse (disa nga këto rekomandime janë e drejta për strehim, e drejtë për të patur një emër, e drejta për arsim etj). Është shumë e rëndësishme që të gjitha këto të drejta të vlerësohen nga të gjithë institucionet përgjegjëse. Përfaqësuesja e zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi **Znj Kaliro Martiko** gjatë prezantimit të saj ka ndarë hapat e ndërmarra nga kjo zyrë për përmirësimin e standardeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të Romëve. Romët përballen me shumë probleme, të tilla si strehimi, arsimimi, punësimi, të mirat dhe shërbimet.

Mbështetja institucionale në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të Romëve në Shqipëri është shumë e rëndësishme. Njohja me këto institucione, ka një rëndësi themelore në realizimin e mbrojtjes së të drejtave të tyre. Çdo institucion ka përgjegjësinë e vet, por bashkëpunimi mes tyre, është i rëndësishëm që të ketë rezultatet më të mira të mundshme në angazhimet e ndërmarra. Në fillim të vitit shkollor 2014 - 2015, Komisioneri ka dërguar disa rekomandime për Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve në mënyrë që të merren masa për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim.

The national network of Roma/Egyptian organizations "Together to strengthen Roma/Egyptian voice in Albania" organized a workshop on "The rights of Roma Minority" held in Tirana on October 21th, 2014. The aim of this workshop was to introduce the participants with the legal framework, policies that serve to protect the Roma minority in Albania, concrete initiatives undertaken for advocating and lobbying. Participants on this workshop were representatives from the Ombudsman institution, the representative of the Commissioner of Anti-discrimination office, the Executive Director of the Albanian Group of Human Rights, the Executive Director of Albanian Helsinki Committee and the representatives of the national Roma/Egyptian network in Albania.

The workshop was organized along three sessions (Session I-Roma Minority and the Legal Framework, Session II-Lobbying & Advocacy, Session III- Actions for the future). The workshop in general involved a participatory approach; all the participants were encouraged to bring their inputs, discuss on the topics and elaborate and provide their own opinion.

The Ombudsman commissioner **Mr. Ermir Kapedani** emphasized that the institution of Ombudsman is a constitutional institution and Roma minority in Albania has been on its attention always. They are a marginalized minority but they have the attention of all international institutions. Mr. Kapedani presented some recommendations that the Ombudsman has sent to the responsible institution (The right to housing, the right to have a name, the right to education). These rights should be evaluated by all the responsible institutions. **Ms. Kaliro Martiko** representative of the Commissioner for Protection from Discrimination office during her presentation shared the steps undertaken by this office for improving the standards related to the protection and respect of the rights of Roma. Roma face many problems in some areas of life, such as housing, education, employment, goods and services.

Institutional support in framework of the protection of the rights of Roma in Albania is very important. Recognition of these institutions has a fundamental importance in the realization of the protection of their rights. Each institution has its own responsibility, but the cooperation between them is important to have the best possible results in the undertaken commitments. At the beginning of the school year 2014 - 2015, the Commissioner has sent recommendations to the Ministry of Education and Sports to take measures to combat discrimination in respect of the right to education.

Dy çështjet kryesore që lidhen me minoritetin Rom dhe të reflektuara në rekomandimin ishin:

1. **Çështjet e regjistrimit, shpërndarja dhe qasja në arsim për fëmijët Romë dhe Egjiptianë.**
2. **Subvencionimi i librave**

Znj. Martiko theksoi se, padiskutim minoriteti Rom do të jetë në fokus të veprimtarisë së Komisionerit edhe në vitet e ardhshme.

Sesioni i dytë u fokusua në çështjen **“Minoriteti Rom dhe Kuadri Ligjor”**. Znj. Vjollca Meçaj - Drejtore Ekzekutive e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, gjatë prezantimit të saj, shpjegoi se cilat janë të drejtat e njeriut dhe pse ne duhet të luftojmë për to. Prezantimi i saj u ndoq me interes nga të pranishmit, të cilët patën mundësi që nëpërmjet pyetjeve të ndryshme, të informoheshin rreth legjislacionit shqiptar dhe atij ndërkombëtar. Pjesa e dytë e këtij sesiioni u fokusuar në punën më grupe. Pjesëmarrësit u ndanë në tre grupe në mënyrë që të identifikohen problemet kryesore me të cilat përballen Romët dhe Egjiptianët.

Disa prej tyre ishin si më poshtë:

- Punësimi (E drejtat për punësim)
- Përfaqësimi (E drejta për tu përfaqësuar)
- Arsimit/Përfshirja e gjuhës, historisë dhe kulturës në kurrikulat e arsimit (Shkollat 9-vjeçare)
- Strehimi - Strehimi Social;
- Vendbanimet jo-formale;
- Familjet që jetojnë në kampin e emergjencave.
- Regjistrimi civil
- Mungesa e infrastrukturës
- Informimi (E drejta për t'u informuar)

Gjatë kësaj seance, Z. Velu sqaroi se në lidhje me përfshirjen e gjuhës Romë në programin shkollor, një iniciativë e ngjashme është ndërmarrë disa vite më parë (2002-2003). Një grup ekspertësh nga disa vende të rajonit kanë punuar për këtë iniciativë. Kjo është një ide shumë e mirë dhe ka nevojë të ndiqet. Drejtoresha ekzekutive e Grupit Shqiptar për të Drejtat e Njeriut, Znj. Elsa Ballauri- sugjeroi rishikimin edhe një herë të kësaj iniciativë të ndërmarrë në 2002-2003, për të vlerësuar të gjitha mundësitë për zbatimin e saj përmes bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve.

Two key issues related to the Roma minority and reflected in the recommendation were:

1. **Issues of registration, distribution and access to education for Roma and Egyptian children.**
2. **Subsidizing textbook**

Ms. Martiko emphasized that the Roma minority will be on the focus of the Commissioner's activity in the coming years.

The second session was focused in **Roma minority and the legal framework**. Ms. Vjollca Meçaj-Executive Director of the Albanian Helsinki Committee during her presentation explained what the human rights are and why we should fight for them. Her presentation was followed with interest by the participants, that through various questions have been informed about Albanian and international legislation. The second part of this session was focused in working with groups. The participants were divided in three groups in order to identify the main problems faced by Roma.

Some of them were as below:

- Employment (the rights to be employed)
- Representation (the rights of be represented)
- Education- Inclusion of language, history and culture in education curricula (9-year-elementary school.)
- Housing-Social Housing;
- Informal housing;
- Families living in the camp of emergencies.
- Civil registration
- Lack of infrastructure
- Information (the rights to be informed)

During this session Mr. Velu explained that regarding the inclusion of the Romani language in the school curriculum, an initiative was undertaken some years ago (2002-2003). A group of experts from several countries in the region worked on this. This is a very good idea and it needs to be followed. Ms. Elsa Ballauri- Executive Director of Albanian group of Human Rights suggested once again reviewing this initiative undertaken in 2002-2003 and evaluating all the options for its implementation through cooperation with the Ministry of Education and Sports.

Lidhur me problemet me të cilat përballen Romët dhe Egjiptianët, Z. Muhamet Rapi (Integrimi Rinor Komunitar) shtoi një tjetër problem i cili është diskriminimi. Ai shpjegoi një rast konkret të diskriminimit të një të riu, i cili u pezullua nga pjesëmarrja në një institucion sportiv në Korçë, për shkak të të qenit Egjiptian. Znj Kaliro Mertiko përfaqësuese e zyrës së Komisionerit për Anti diskriminimin, sygjeroi që nëpërmjet një letre drejtuar zyrës që ajo përfaqëson, të ndiqet ky rast.

Sesioni i dytë u hap nga drejtoresha ekzekutive e Grupit Shqiptar për të Drejtat e Njeriut Znj. Elsa Ballauri. Ajo e filloi prezantimin e saj duke ndjekur rastin që Z. Rapi përmendi. Sipas saj, në Shqipëri ekziston një ligj kundër diskriminimit dhe ky është një ligj i cili është miratuar në saj të avokimit dhe lobimit të shoqërisë civile. Ka shumë mundësi ligjore, por përdorimi i tyre nuk është aty ku duhet të jetë. Në përgjithësi, qeveritë nuk janë transparente. Të gjithë qytetarët kanë të drejtë për informacion dhe qeveritë e kanë për detyrë që të jetë transparente me publikun.

Nëse shoqëria nuk është aktive, atëherë nuk ka advokim. Ka mënyra të ndryshme për të bërë advokaci, por ndonjëherë është e rëndësishme për të ndjekur strategjinë e duhur. Për këtë arsye mund të kërkohet ndihmë tek ekspertët e avokimit. Ata mund të ndihmojnë nëpërmjet rekomandimeve se cilat mund të jenë mënyrat më të mira për të mbrojtur një çështje. Media është gjithashtu një mjet shumë i rëndësishëm që mund të ndihmojë shumë në arritjen e qëllimeve. Ajo çfarë është shumë e rëndësishme, është se çështja duhet të jetë e strukturuar mirë dhe të dihet se çfarë kërkohet. Formimi i rrjeteve, është një mënyrë shumë e mirë për të forcuar zërin, por është shumë e rëndësishme mënyra se si mund të organizohet dhe bashkëpunohet mes njëri-tjetrit.

Gjatë sesionit të III në planin për të ardhmen, anëtarë të ndryshëm të rrjetit diskutuan edhe disa nga arsyet se pse ata janë pjesë e kësaj nisme. Shumica e tyre besojnë se së bashku, zëri i tyre do të dëgjohet më shumë. Në këtë rrjet, ata ndihen të lirë për të dhënë mendimet e tyre dhe për të ndërmarrë hapa në ndryshimin e situatës. Ata e respektojnë Amaro-Drom për punën e bërë për komunitetin Rom ndër vite.

Regarding the problems faced by Roma and Egyptians Mr. Muhamet Rapi from the Community Youth Integration association added another problem which is the discrimination. He explained a concrete case of a discriminated youth that was suspended by a sportive institution in Korca because of being Egyptian. Ms. Kaliro Mertiko the representative of the Anti discrimination Commissioner suggested that by sending a letter to the office that she represents, this case will be followed.

The second session was opened by Ms. Elsa Ballauri Executive Director of Albanian Group of Human Rights. She started her presentation following what Mr. Rapi mentioned. In Albania there is a law against discrimination and this is a law which was approved thanks to advocacy and lobbying of civil society. There are many legal opportunities but their use is not where it should be. In general, the governments are not transparent. All citizens have the right to information and governments have a duty to be transparent with the public.

If the society is not active then there is no advocacy. There are different ways to do advocacy, but sometimes it is important to follow the proper strategy. For the advocacy, experts can help in this direction, by providing information on the best ways to advocate. Media is also a very important tool that can help a lot in achieving the goals. What is very important is that we have to be well structured and to know what we seek. The networks are a good way to strengthen the voice but it is very important the way of how they can cooperate and be organized.

During the third session (the future plan of the network), different members of the network, discussed also about some of the reasons why they are part of this initiative. Most of them believe then together their voice will be heard. They feel free to give their opinions and to undertake steps in changing the situation. They respect Amaro-Drom Union for the work done for Roma community during years.

Disa sygjerrime për vazhdimësinë ishin:

- Të gjithë antarët e rrjetit duhet të japin kontributin e tyre në ndihmë të komuniteteve që përfaqësojnë;
- Rrjetit duhet të konsolidohet në mënyrë që më pas të mendohet për strukturat;
- Të gjithë duhet të punojnë për të pajisur rrjetin me informacion (Informacioni duhet të vijë nga çdo komunitet në mënyrë që zgjidhja të jetë sa më e shpejtë);
- Duhet të ketë shkëmbim informacioni dhe eksperience;
- Të ndërmerren inisiativa ligjore konkrete për të ndihmuar komunitetin.

Some suggestions for the future of the network were:

- Everyone from the participants in this network have to give his own contribution.
- The network should be consolidated we have to think about the structures.
- Everyone should work to update the network with information (the information should come from each community in order to have a rapid response to the situation)
- There is needed exchanging of experience and information.
- It is necessary that the network members undertake concrete legal initiatives.




Një tjetër çështje e rëndësishme që u diskutua gjatë workshopit, ishte një rast mbi situatën e strehimit për disa familjeve Rome dhe Egjiptiane në Korçë. Anëtarët e rrjetit ndanë me njëri-tjetrit të gjitha informacionet që kishin për situatën dhe dhanë rekomandime të qarta për ndërhyrje të mëtejshme.

Another important issue discussed during the workshop was the case of housing situation for some Roma and Egyptian families in Korça. The network members shared with each other all the information for the situation and gave clear recommendation for further intervention.

LOBIM DHE ADVOKIM I RRJETIT NË NIVEL KOMBËTAR

JOINT LOBBY AND ADVOCACY BY THE NETWORK AT THE NATIONAL LEVEL



Iniciative lobimi për situatën e strehimit në Korçë

Gjatë muajit Tetor 2014, 18 familje (Rom, Egjyptian, dhe maxhorancë) në qytetin e Korçës ishin në rrezik për t'u dëbuar nga banesat sociale. Këto familje janë përfituese të banesave sociale me kredi të zbutur që nga viti 2007. Për disa vite, për shkak se ata kanë humbur të ardhurat e tyre nga punësimi apo burime të tjera, këto familje nuk ishin në gjendje për të paguar këstin e kredisë. Si rrjedhojë, 14 familje ishin në proces gjyqësor dhe 4 familje të tjera morën një urdhër për të lënë shtëpitë e tyre brenda muajit Tetor 2014.

Unioni "Amaro-Drom" së bashku me Rrjetin Kombëtar të organizatave Rome dhe Egjyptiane "Së bashku për forcimin e Zërit të Romëve në Shqipëri" dërgoi një kërkesë zyrtare në institucionet përgjegjëse duke kërkuar:

- **Bashkisë Korçë:** Të japë bonus qiraje për 4 familjet që janë më në rrezik për t'u dëbuar.
- **Drejtoria Rajonale të Punësimit:** Të ofrojë mundësinë e punësimit për anëtarët e 4 familjeve në nevojë, në mënyrë që të sigurojnë të ardhura.
- **Entit kombëtar të banesave:** (institucioni që ofron banesa sociale) që të zgjasë periudhën e pagesës së kredisë për këto familje.

Pas lobimit të madh të bërë nga thujtse e gjithë Shoqëria Civile Shqiptare ka pasur një reagim nga institucionet përgjegjëse;

- **Bashkia e Korçës,** do të japë 30 USD në muaj për këto 4 familje.
- **Drejtoria Rajonale e Punësimit,** do të punësojnë kryefamiljarët e këtyre familjeve.
- **Enti Kombëtar i Banesave,** vendosi që shuma e papaguar e parave nga këto familje të shpërndahen në këste më të vogla në vitet e ardhshme.

Kjo ishte një zgjidhje e përkohshme e kësaj situatë, por tani këto familje të paktën nuk janë në rrezik për t'u dëbuar nga shtëpitë e tyre.

Lobbing initiative for the housing situation in Korça

During October 2014, 18 families (Roma, Egyptian, and majority) in Korça city were at risk to be evicted from social housing. These families are beneficiaries of social housing with loan since 2007. These families were not able to pay the loan installment for several years because they have lost their income from employment or other sources.

As a consequence, 14 of the families are in judicial process and 4 families received an order to leave their houses within October 2014.

Amaro-Drom together with the National Roma Network "Together to strengthening Roma Voice in Albania" sent an official request to responsible institutions by asking:

- **Korça Municipality:** To give rent bonus for 4 families who are most at risk.
- **The Regional Directory of Labor Office:** To employ members of 4 vulnerable families in order to provide revenues.
- **Housing Entity:** To extend the loan payment period.

After this request and lobbying by all the Albanian Civil Society, there was a reaction from the responsible institution;

- **Korça Municipality,** will give 30 USD per month for these 4 families.
- **The Regional Directory of Labor Office,** will employ the householders of these families.
- **Housing Entity,** decided that the unpaid sum of money by these families will be distributed in small installments in the coming years.

This is a temporary solution of this situation but now these families are not at risk to be evicted from their houses.

Rrjeti bëhet pjesë e iniciativës për firmosjen e deklaratës mbi legalizimin e shtëpive

Në qytetin e Tiranës, lagjia Selite 120 familje janë prekur nga plani urbanistik. Fillimisht kanë qënë 120 familje të cilat janë prekur nga ky plan. Aktualisht pasi janë arritur të kompensohen një pjesë e tyre, kanë ngelur pa përgjigje rreth 47 familje, të cilët gjatë vitit 2006 kanë nisur procesin e legalizimit duke paguar dhe tarifen përkatëse, por janë ende me shtëpi të palegalizuara. Banoret ndihen të shqetësuar pasi jetojnë që prej 20 vitesh në këtë zone dhe nuk kanë marrë asnjë përgjigje nga institucionet përkatëse për ecurinë e këtij procesi. Disa prej shtëpive kanë filluar të prishen. Nga ana tjetër institucioni i Avokatit të Popullit i ka marrë në shqyrtim ankesat e banoreve duke dërguar shkresa zyrtare për të marrë informacion nga institucioni i Bashkisë.


Pas njoftimit të marrë, për një takim të Avokatit të Popullit me banorët e lagjes së Selitës Tiranë, përfaqësues nga zyra e Amaro-Drom, kanë shkuar dhe kanë dëgjuar nga afër shqetësimet e banoreve.

Organizatave të shoqërisë civile, duke parë situatat e krijuara për debimet nga shtëpitë kanë ndërmarrë një nismë duke hartuar një deklaratë e cila u firmos nga 20.000 persona (përfaqësues të organizatave, aktivistë, qytetarë, ndër të tjera dhe organizatat e rrjetit). Deklarata u dorëzua pranë institucioneve përgjegjëse.

The network has been part of the initiative for signing the declaration about housing legalization

In Tirana city, Selite neighborhood, 120 families are affected by the city urban plan. Initially 120 families were affected by this plan. Currently, a part of them was compensated but there are still 47 families waiting for a response. In 2006 these families started the legalization process by paying the appropriate fee but their houses are still without legalization. Roma families, residents in this neighborhood for more than 20 years never received any response by the relevant institutions for this process. This situation created disappointment among Rom families. On the other hand, Ombudsman Institution has taken into consideration the complaints of the residents by sending official letters to receive information from the Municipality Institution.

After taking the notification for a meeting of the Ombudsman with the residents of Selite Neighborhood in Tirana, representatives from the Amaro-Drom Office were in the field to hear closely the concerns of the residents. Based on the created situation, the Civil Society Organizations undertook an initiative to draft a declaration which was signed by 20.000 people (representatives of the organizations, activists, citizens, and among others the network organizations). The declaration was addressed to the responsible institutions.



Harta e organizatave Rome/Egjyptiane në Shqipëri.

- Organizatat e Tiranës
- Organizatat e Korçës
- Organizatat e Pogradecit
- Organizata e Elbasanit
- Organizata e Fierit
- Organizata e Lezhës